



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET
KRYETARI
Niko PELESHI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2024**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke konsideruar tejet të rëndësishëm misionin kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke njohur, respektuar dhe mbështetur pavarësinë ligjore dhe institucionale të institucionit të SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit);

Duke vlerësuar rolin e saj të rëndësishëm në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë;

Duke vlerësuar angazhimin dhe rezultatet e arritura nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit gjatë vitit 2024 në përmbushje të përgjegjësiave të tyre kushtetuese dhe ligjore dhe në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë;

Duke marrë në konsideratë rritjen e besimit të publikut dhe të partnerëve ndërkombëtarë, si dhe vlerësimet pozitive të shprehura për veprimtarinë e këtij institucioni nga BE-ja edhe në kuadrin e anëtarësimit të vendit në BE;

Në vlerësim të raportit të paraqitur për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij konstaton:

Përmirësim të treguesve statistikorë të hetimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme, veçanërisht për hetimet e nisura kryesisht, rritjes së procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2024, si dhe intensifikimit të hetimeve financiare.

Rritje të ndjeshme të vlerës së pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në vlerën totale prej rreth 65.5 milionë eurosh, çka përfaqëson një rritje me 59.7% krahasuar me vitin 2023 dhe konfirmon efektivitetin në luftën kundër pasurimit të paligjshëm dhe pastrimit të parave.

Ruajtjen e një qasjeje proaktive në regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe rritje të numrit të hetimeve të nisura në këtë formë, duke reflektuar angazhimin institucional për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Përmirësimin e kapaciteteve institucionale përmes miratimit të udhëzimeve të reja, forcimit të hetimeve financiare, përfshirë hetimet me kriptovaluta, dhe zhvillimit të trajnimeve të specializuara për hetuesit dhe prokurorët.

Miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e brendshëm të institucionit dhe forcimin e integritetit dhe etikës institucionale.

Miratimin e Strategjisë së Komunikimit me Publikun për përmirësimin e marrëdhënieve me median dhe me publikun.

Angazhimin për hartimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025, si shprehje e vullnetit për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të ndjekur penalisht çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

Bashkëpunim të mirë dhe të qëndrueshëm me autoritetet e drejtësisë e agjencitë ligjzbatuese të BE-së, vendeve anëtare të saj dhe më gjerë, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja dhe krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore ndërkombëtare, të cilat përbëjnë një praktikë të mirë në luftën ndërkombëtare kundër krimit të organizuar.

Kuvendi rekomandon që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2025 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Ngritjen e një grupi pune në bashkëpunim edhe me Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për përgatitjen e një analize për Grupet e Krimit të Organizuar aktive në aktivitetin e tyre brenda e jashtë vendit dhe strategjinë e thellimit të luftës kundër tyre.

2. Përgatitjen e një analize për masat e sigurisë të marra në këto 5 vjet (2021 – 2025), politikat e ndjekura, problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për reflektim në praktikën e vendeve europiane në këtë fushë dhe standardet e rekomanduara nga KiE, BE, GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

3. Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe KQZ-në, të zhvillojnë një analizë të përbashkët për zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025 dhe masat ligjore e institucionale që mund të ndërmerren për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të parandaluar e ndëshkuar çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

4. Zgjerimin e përdorimit të teknologjive të avancuara për gjurmimin e pasurive dhe rrjeteve financiare për çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

5. Vijimin e përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve teknike dhe logjistike për hetimet financiare, hetimin e krimeve kibernetike dhe pastrimit të parave, përfshirë kriptovalutat edhe përmes trajnimeve të specializuara dhe bashkëpunimit më të ngushtë me Europol dhe EMPACT.

6. Të bëhen përpjekje për unifikimin/standardizimin e metodologjisë së hetimit lidhur me marrjen e provave dhe masat e sigurisë etj., bazuar edhe në vendimet njëseuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet e GJEDNJ-së.

7. Finalizimin e miratimit të akteve të mbetura nënligjore, përfshirë udhërrëfyesin për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe aktet që lidhen me qarkullimin e brendshëm të dosjeve etj.

8. Zbatimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, përfshirë aktivizimin e moduleve të mbetura dhe përdorimin e sistemit për raportim të brendshëm dhe gjenerim statistikash në kohë reale.

9. Rritjen e efikasitetit institucional të Byrosë Kombëtare të Hetimit në zbatim të përcaktimeve të ligjit organik përmes plotësimit të vakancave dhe sigurimit të kushteve të nevojshme logjistike për funksionim të plotë të strukturës.

10. Vazhdimin e përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatim edhe të rekomandimeve të BE-së duke intensifikuar bashkëpunimin me agjencitë e BE-së (Eurojust, Europol, OLAF) dhe vendet anëtare për ndjekjen e çështjeve transnacionale për të përmbushur plotësisht rekomandimet e progresraportit të BE-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

Miratuar në datën 30.10.2025